

VENDIM
Nr.899, datë 29.12.2004

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS SË
VARREZAVE TË REJA, NË QYTETIN E SHIJAKUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës së varrezave të reja, në qytetin e Shijakut.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shijakut.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 523, 6 m², e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 523 600 (pesëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind) lekësh.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 235 000 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.
 5. Fondi prej 758 600 (shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekësh, të përballohet nga bashkia e Shijakut, e cila të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në muajin janar 2005.
 7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Shijakut për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS SË
VARREZAVE NË QYTETIN E SHIJAKUT**

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
1.	Sali Keçi	153.6 m ²	1000	153 600
2.	Pëllumb Keçi	130.6 m ²	1000	130 600
3.	Artan Keçi	63 m ²	1000	63 000
4.	Asllan Keçi	176.4 m ²	1000	176 400

Vlera totale e shpronësimit është 523 600 (pesëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind) lekë.